

Ndikimi i pengesave të performancës në ngarkesën e infermierëve në kujdesin intensiv, cilësia e kujdesit dhe siguria e pacientit

Kuci Andoresa¹; Brajshori Naime¹

Kolegji Heimerer

Pengesat e performancës janë “Karakteristikat e dizajnit të sistemit të punës që pengojnë punën (Peters dhe O’Connor, 1988). Këto pengesa të performancës janë pengesa që ndikojnë në aftësinë për të kryer punët e tyre dhe e zvogëlojnë sigurinë e pacientit (Gurses, Carayon dhe Wall, 2009). **QËLLIMI** i këtij hulumtimi është që të identifikohen dimensionet e ndryshme të pengesave të performances dhe ndërlidhja e ndikueshmërisë së tyre në ngarkesën e infermierëve, cilësinë e kujdesit dhe sigurinë e pacientit.

METODOLOGJIA: Të dhënat janë mbledhur përmes anketimit me anë të dy pyetësorëve: “Performace obstacles of ICU” nga Gurses dhe Carayon (2009) dhe “The Safety Attitude Questionnaire” nga Sexton, Thomas dhe Helmreich (2006), si dhe shqyrtimit të literaturës shkencore. Mostra për realizimin e hulumtimit kanë qenë infermieret e njësisive intensive të: Qendrës Klinike Universitare te Kosovës (QKUK), Spitalit te Përgjithshëm (Pejë) dhe Spitalit të Përgjithshëm (Gjakovë).

REZULTATET: Numri i mostrës ka qenë 78 infermier. Numri më i madh i tyre kanë pohuar “Shoqërimin intraspitalor gjatë transportit të pacientit” si pengesën më të madhe të performances se tyre. Kjo pengesë ka dale të ketë një ndërlidhje pozitive me ngarkesën e infermierëve dhe dëmtimin e performancës së tyre.

KONKLUZIONET: Hulumtimi ka nxjerrë se kujdesi intensiv ka një kulturë të lartë të të mësuarit nga gabimet e të tjerëve që iu ndihmon infermierëve në zgjidhjen e përshtatshme të gabimeve mjekësore dhe në siguri të lartë të pacientit. Hulumtimi ka vërtetuar gjithashtu se pengesat kanë ndërlidhje signifikante mbi cilësinë e kujdesit, mbingarkesat i rrisin gjasat për gabime në situata të tensionuara dhe jo efektivitetin në punë, si dhe infermierët kanë deklaruar se nivelet e personelit janë të pamjaftueshme për numrin e pacientëve çka indikon në komprometim të cilësisë së kujdesit të ofruar.

Fjalet kyqe: Infermier, kujdesi intensiv, pengesë, ngarkesë, cilësi, siguri.